

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 25147/26

Nr. i fq. / Br. st. -6-

Data: / Datum 16.06.2026

VUSHTPRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria për Arsim

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 5, shkronja b) të Ligjit nr. 03/ L068 për Arsimin në Komunal e Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 08/L-153 mbi edukimin në fëmijërinë e hershme, në nenin 4 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) nr. 03/ 2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Drejtoria e Arsimit shpallë këtë:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË PËR VITIN 2026/2027

IP "Foleja 1" - Vushtrri

Grupmosha	Vende të lira
0-2 vjeç	6
2-3 vjeç	0
3-4 vjeç	15
4-5 vjeç	17
5-6 vjeç	0
Gjithsej	38

IP "Foleja 2" - Vushtrri

Grupmosha	Vende të lira
0-2 vjeç	10
2-3 vjeç	0
3-4 vjeç	0
4-5 vjeç	0
5-6 vjeç	0
Gjithsej	10

IP "Foleja 3" - Vushtrri

Grupmosha	Vende të lira
0-2 vjeç	7
2-3 vjeç	0
3-4 vjeç	0
4-5 vjeç	0
5-6 vjeç	0
Gjithsej	7

Sqarim: Numri i fëmijëve në një grup përcaktohet sipas UA nr. 03/2022, për përfshirjen e fëmijëve në IP në Kosovë

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

Formulari i aplikimit (merret në institucionin përkatës parashkollor);

Dokumenti personal i prindit (letërnjoftim ose pasaportë);

Ekstraktin e lindjes së fëmijës;

Për qiramarrësit - Kontratë e noterizuar mbi qiranë;

Dëshmia për vaksinimin e fëmijës (fletorja e shëndetit të fëmijës);

Vërtetimi për marrëdhënien e punës për të dy prindërit (nëse prindërit janë në marrëdhënie pune);

Pasqyra e Trustit për gjashtë (6) mujorin e fundit;

Dëshminë që ka fëmijë të tjerë të regjistruar në institucionin parashkollor përkatës;

II. Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore

Regjistrimi i fëmijëve në IP do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushë e arsimit parashkollor (Ligjit nr. 08/L-153 mbi edukimin në fëmijërinë e hershme), në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 03/ 2022 për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë dhe në Vendimin e kriterëve të pranimin të fëmijëve në institucionet parashkollore publike të Drejtorisë së Arsimit.

III. Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur nga data e publikimit më **17.06.2026** deri më datën **01.07.2026**;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në institucionin parashkollor përkatës çdo ditë pune prej orës **08:00 deri në ora 16:00**;

Palët e pakënaqura me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në institucionin parashkollor përkatës në afat prej tetë (8) ditëve pas datës së publikimit të rezultateve;

Palët e pakënaqura me përgjigjen e IP-së, mund të ushtrojnë ankesë në DKA, si shkallë e dytë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve; DKA nuk shqyrton asnjë ankesë, nëse e njëjta nuk është shqyrtuar me shkrim nga IP përkatëse.

Të gjitha dokumentacionet e pakompletuara dhe jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

III.1. PËR KRITERET E PRANIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE

I. Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të komunës së Vushtrisë mund të regjistrohen në institucionet parashkollore publike (IP) të Komunës së Vushtrisë;

II. Planifikimin për numrin e fëmijëve që do të pranohen në IP e bëjnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të IP-ve;

III. Në institucionet parashkollore publike mund të regjistrohen fëmijët prej moshës 9 muaj deri në 6 vjeç;

IV. Llogaritja e moshës së fëmijëve nuk bëhet duke marrë parasysh datën e regjistrimit, por datën e fillimit të shërbimit, përkatësisht duke marrë parasysh datën 31 Gusht;

V. Nëse Komisioni i pranimin të fëmijëve gjatë procesit të regjistrimit konstaton se ka dy e më shumë fëmijë me pikë të barabarta, atëherë duhet praktikuar shortin, i cili bëhet në prani të prindërve të fëmijëve dhe KDSH-së përkatëse. E njëjta procedurë kur fëmijët kanë pikë të barabarta vlen edhe për fëmijët që mbesin në listën pritëse (të papranuar), që sistemohen

përgjatë vitit edukativ;

VI. Pranimi i fëmijëve në IP bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat bazuar në kriteret e specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Pikëzimi sipas kategorisë	Pika
1	Fëmijët bonjakë pa të dy prindërit	100
2	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i punësuar	90
3	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i papunësuar	80
4	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse të dy prindërit punojnë	80
5	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse njëri prind punon	60
6	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse asnjëri prind nuk punon	40
7	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar	60
8	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i papunësuar	30
9	Prindërit e fëmijëve në asistencë sociale	50
10	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	40
11	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	30
12	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	20
13	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	20
14	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	15
15	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	10
16	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve deri në 400 euro)	45
17	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 401 -700 euro)	35
18	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 701-1000 euro)	25
19	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve mbi 1000 euro)	15
20	Fëmijët e prindërve që janë banues në lagjen-Bashkësinë Lokale ku gjendet IP-ja	20
21	Fëmijët e punëtorëve të IP-ve	10
22	Fëmijët e prindërve që tashmë kanë një fëmijë vijues në IP-në përkatëse	10
23	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit deri në 300 euro)	20
24	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit 300 - 700 euro)	15
25	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit 701 - 1000 euro)	10
26	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit mbi 1000 euro)	5

IV. Për lirim nga pagesa për fëmijët në Institucione Parashkollore për vitin edukativ 2026/2027.

Të drejtë lirim nga pagesa kanë vetëm:

- a) Fëmijët e invalidëve të luftës lirohen nga pagesa 100%
- b) Fëmijët bonjakë (pa të dy prindërit) 100%;
- c) Fëmijët me nevoja të veçanta 100%
- d) Fëmijët në asistencë sociale 100%
- ç) Fëmijët me njërin prind lirohen 100%;
- d) Fëmijët e veteranëve të luftës 100%;
- e) Prindërit që kanë më shumë se një fëmijë në IP të regjistruar, për një fëmijë do ta paguaj tarifën e plotë, për fëmijën e dytë lirohet 30%, për fëmijën e tretë lirohet 50% nga tarifa aktuale (kjo kategori mund të aplikoj vetëm në një Institucion Parashkollor).

V. Të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet ti paraqesin këto dokumente:

- Kërkesën për lirim nga pagesa për vitin 2026/2027
- Certifikatën e lindjes së fëmijëve
- Kopjen kontratës me IP

Invalidët e luftës duhet t'i paraqesin edhe:

- Vendimin origjinal (ose kopjen e vërtetuar të noterit) të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të pensionit për invalid të luftës;

Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta edhe:

- Vërtetimin zyrtar për fëmijën me nevoja të veçanta (vërtetimi nga HANDIKOS apo nga Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale).

Prindërit e fëmijëve në asistencë sociale edhe:

- Vërtetimin zyrtar që dëshmon periudhën aktuale që janë në asistencë sociale nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kujdestaret fëmijëve bonjakë (pa të dy prindërit) edhe:

- Certifikatën e vdekjes së prindërve (origjinale)

Prindi i vetëm pa bashkëshorte/bashkëshort edhe:

- Certifikatën e vdekjes së bashkëshortit/ës (origjinale)

Prindi vetë ushqyes edhe:

- Dëshmi na Gjykata ose konstatimi (dokument zyrtar) nga

Qendra për Punë Sociale se njëri nga prindërit është duke u kujdesur për fëmijët.

Prindërit që kanë me shumë se një fëmijë të regjistruar ne çerdhet publike edhe:

-Certifikatën e lindjes të secilit fëmijë (origjinale) dhe fletëregjistrimin e tyre në institucionet përkatëse.


VËMENDJE:

Për të gjitha rastet e liruara nga pagesa prindërit/kujdestarët ligjor, duhet të dëshmojnë me dokument zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kërkesën e lirit, në të kundërtën e njëjta do të refuzohet.

VI. Lirimi nga pagesa, bëhet nga shtatori i vitit 2026 deri 31 gusht 2027.

Vushtrri

16.06.2026

Naile Bekteshi

Drejtoreshë e DKA-së

